**Practice 2:** Complete the first sentence as an example in ex. 2. Check students' understanding of the phrasal verb plug in, which means to insert a plug into a socket. Ask students to read the text in ex. 3. Read out the question and elicit the correct answer. Put students into pairs to complete the text in Exercise 3 with the correct form of the verbs in brackets.

Play the recording for students to check their answers. Students work alone for the remaining exercises. I check their answers.

**EVALUATION:** Based on their preparation.

**HOMEWORK:** Workbook exercises

#### 4. Aktivitet me nxënësit



#### 5. Punë grupi



## 7. Ftesë për ditëlindje



## 8. Eksperiment shkencor

Eksperiment shkencor:

Tema: Elektrizimi i trupave  
Ora 1  
Emri: Xhensika Pasho  
Data: 06.02.2023

Zgjidhja e problemit

Hipotezat

Materialet:


Vëzhgimet dhe përfundimet

Hapat e eksperimentit

Rezultatet



## 9. Stuhi mendimesh



### PËRFUNDIME

Qëllimi i këtij punimi ishte të prezantonte përdorime praktike të mjetit grafik digjital: canva.com në mësimdhënie. Këto përdorime u sollën nga mësuesit dhe drejtuesit e shkollave 9-vjeçare dhe të mesme në qytetin e Korçës gjatë trajnimit të mbajtur më 3-4 shkurt 2023 në Universitetin “Fan S. Noli”, Korçë. Ato u njohën më nga afër me këtë mjet grafik digjital i cili mund të përdoret lehtësisht për të promovuar të mësuarit. Smaldino etj. (2015) deklaroi se Canva.com mund të shërbejë për qëllime të tilla si; 1) konkretizimi i ideve abstrakte; 2) motivimi i nxënësve; 3) tërheqja e vëmendjes në mënyrë të drejtpërdrejtë; 4) të kujtuarit e njohurive të mëparshme. Përveç kësaj, ky mjet mund të japë frymë positive çdo mjedisi mësimor nëpërmjet çdo lehtësie të ofruar, duke ndikuar kështu në përqendrimin, kujtesën dhe sjelljen e nxënësve. Nëse nxënësit ndihen optimistë për të punuar në canva.com, ata gjithashtu do të ndihen më të sigurt në procesin mësimor. Canva mund të japë një përvojë unike në të cilën nxënësit duhet të angazhohen në procesin krijues.

Ashtu siç u vu re nga shembujt e sjelle më sipër, Canva.com u përdor nga mësuesit për të krijuar: postera, projekte me nxënësit, plane mësimore, aktivitete me nxënësit, punë në grup, kopertinë e një reviste, ftesë për ditëlindje, eksperiment shkencor dhe stuhi mendimesh.

Veçoritë tërheqëse që janë tashmë në dispozicion mund ta bëjnë më të lehtë për të gjithë. Sipas këtyre rezultateve Canva është një mjet shumë i dobishëm për

përdorim nga të gjithë mësuesit dhe mund ta bëjë më të lehtë përcjelljen e njohurive për ata që e përdorin.

## **BIBLIOGRAFIA**

<https://www.canva.com/>

Smaldino, S. E., Lowther, D. L., Mims, C., & Russell, J. D. (2015). *Instructional Technology and Media for Learning* (Eleventh E).

# MODEL ORGANIZIMI I NJË ORE MËSIMORE NËPËRMJET KOMPETENCËS DIGJITALE DHE BASHKËPUNIMIT VIRTUAL

Dr. Eriola Qafzezi  
[eqafzezi@unkorce.edu.al](mailto:eqafzezi@unkorce.edu.al)

## Objektivat e të nxënit:

- Të pasurohet fjalori i nxënësve.
- Të zhvillohen aftësitë e dëgjimit.
- Të përfshihen nxënësit në bashkëbisedim të kuptimshëm dhe të qëllimshëm.
- Të ndërthuren të katër aftësitë.
- Të integrohet kompetenca digjitale si dhe të nxënit nëpërmjet bashkëpunimit virtual.
- Të nxitet bashkëpunimi me teknologjinë, me nxënësit dhe bashkëpunimi me nxënësit i ndërmjetësuar nga teknologjia.
- Të përfshihen nxënësit në punë në role, sipas përgjegjësi të përcaktuara qartë.
- Të përfshihen nxënësit në vlerësimin e pjesëtarëve të grupit dhe nxënësve të tjerë.

## Kohëzgjatja e mësimit:

Një orë mësimore, 45 minuta.

## Përshkrimi i kontekstit:

Nxënësit janë në një orë mësimi që fokusohet në aktivitete me qëllim zhvillimin e aftësive të të dëgjuarit, në kombinim me aftësitë e të folurit. Nxënësit kanë njohuri të anglishtes në nivelin B2. Ata janë të aftë të përdorin një sërë platformash online si dhe kanë përvojë në bashkëpunimin virtual dhe përfshirjen e kompetencës digjitale në procesin e mësimnxënies.


## Aktiviteti 1:

### Para dëgjimit – 15 minuta



Nxënësit ndahen në breakout rooms (nëse janë online) ose në grupe (nëse janë në klasë) dhe punojnë sipas fishave dhe roleve të mëposhtme.

Pyetja e diskutimit: What makes a hero? (Ky është edhe titulli i tekstit që do të dëgjohej në aktivitetin e dytë).

### Seti i fishave nr. 1 Ekspertët e fushave




Seti i fishave nr. 2 Rolet e mundshme



Për të integruar bashkëpunimin virtual dhe kompetencën digjitale, nxënësit ndahen në dy grupe (breakout rooms) dhe kërkojnë në [www.visuwords.com](http://www.visuwords.com) kombinime të mundshme të fjalët ‘hero’ sipas konteksteve të caktuara. Më pas, grupet bashkohen dhe diskutojnë rreth kombinimeve të gjetura. Mësuesi është në rolin e inkurajuesit. Nxënësit kanë rolet dhe përgjegjësitë e tyre brenda grupeve, të bëra të qarta paraprakisht.

**Fig. nr. 1** Ilustrim i kërkimit online në [www.visuwords.com](http://www.visuwords.com)



Sipas grupeve përkatëse, organizohet puna për kërkime të mëtejshme për zgjerimin e fjalorit dhe nxitjen e diskutimeve.

### Seti i fishave nr. 3 Diskutime të mëtejshme në grupe




Fig. nr 2 Ilustrime të kërkimit online të imazheve, diskutime të mëtejshme



Sipas grupeve dhe roleve, një nxënës brenda grupit krijon një quiz në lidhje me materialin e dëgjuar nëpërmjet mjeteve dhe platformave të prezantuara tashmë dhe shpërndan link-un për nxënësit e tjerë që e plotësojnë quizin në kohë reale. Nëse është e nevojshme, nxënësit dëgjojnë edhe një herë materialin.

#### Seti i fishave nr. 4 Pyetje të mundshme për një quiz në lidhje me materialin




#### Aktiviteti nr. 3

##### Pas dëgjimit - 10 min

Nxënësit ftohen të diskutojnë bashkarisht në lidhje me materialin që dëgjuan. Nxënësi në rolin e intervistuesit drejton pyetje dhe motivon bisedën. Të gjithë nxënësit duhet të motivohen të marrin pjesë në diskutim, sepse diskutimi do të jetë pikënisja e detyrës së shtëpisë.

#### Seti i fishave nr. 5 Pyetje për diskutim në grup



#### **Aktiviteti nr. 4:**

#### **Detyrë shtëpie – Mbledhja e të dhënave nëpërmjet kërkimit online – punë në grupe**

#### **Shpjegimi i detyrës - 5 minuta**

**Rubrika:** Dëgjoni video online, lajme, blogje, etj., dhe gjeni shembuj të veprimeve heroike, shembuj të heronjve në letërsinë e hershme dhe/ose atë moderne, heronjtë e filmave, etj. Pas një jave, postoni detyrën tuaj në platformën online ku kanë akses të gjithë nxënësit. Përshkruani heroin e përzgjedhur, veprimet e tij dhe shprehni mendimin tuaj nëse jeni dakord me veprimet e heroit apo jo. Argumentoni qëndrimin tuaj. Të gjithë studentët duhet të aksesojnë detyrat e postuara dhe të bëjnë të paktën një koment në lidhje me detyrën e nxënësve të tjerë, duke shprehur opinionin e tyre kundrejt opinionit të nxënësit që ka postuar detyrën. Nxënësit do të vlerësohen 80% bazuar në detyra e tyre dhe 20% bazuar në komenti në lidhje me detyrën e nxënësve të tjerë. Kriteret për vlerësimin e detyrës janë postuar paraprakisht në platformën online ku komunikojnë virtualisht nxënësit me njëri-tjetrin dhe mësuesin.



# MËSIMDHËNIA E GJUHËS FRËNGE PËRMES DISA MJETEVE DIGJITALE (TV5 MONDE, FRAMAPAD, FRANÇAIS FACILE AVEC RFI, ETJ.)

**Dr. Fabiola KADI**  
[fkadi@unkorce.edu.al](mailto:fkadi@unkorce.edu.al)

## **Përdorimi i fishave të gatshëm të TV5Monde**

Të rinjtë sot tërhiqen gjithnjë e më tepër nga teknologjia dhe shpesh për mësimdhënësit bëhet e vështirë tërheqja e tyre përmes librit apo metodave të ndryshme të mësimdhënies. Vënia në përdorim e mjeteve digjitale për t'i tërhequr dhe afruar më tepër nxënësit me mësimin e gjuhës së huaj është kthyer në një domosdoshmëri, por edhe sfidë për mësuesit e gjuhëve të huaja. Për mësimdhënien e gjuhës frënge, sidomos pas situatës së krijuar nga COVID-19, ekzistojnë shumë mjete për mësimdhënien në distancë, por të cilat mund të përdoren më së miri edhe në mësimdhënien në klasë apo edhe për një mësimdhënie të përzierë. Fishat e gatshme të TV5 Monde, apo të Français facile u vijnë në ndihmë mësuesve të çdo niveli e moshe, duke pasur një përshtatshmëri për sa i përket nivelit gramatikor, ashtu edhe leksikor të nxënësit. Çdo fishë pedagogjike TV5 Monde përmban rreth 5-6 aktivitete të lidhura me një video që nxënësit duhet të shohin paraprakisht. Përmes këtyre fishave mësuesi mund të kontrollojë të gjitha kompetencat e një nxënësi për sa i përket të kuptuarit të shkrimit, dëgjimit dhe gjithashtu të shprehurit me shkrim dhe me gojë në gjuhën frënge. Nga ana tjetër, fishat e TV5 Monde janë ndërtuar në mënyrë të tillë që i lejojnë mësuesit të vlerësojnë nivelin gramatikor, leksikor dhe sintaksor. Përshtatja e fishave të TV5 Monde në një klasë virtuale duhet bërë duke pasur parasysh nivelin e gjuhës dhe qëllimet e secilit për të mësuar gjuhën frënge. Nga ana tjetër këto fisha janë tashmë të përgatitura, të përcaktuara sipas niveleve të gjuhës e kështu në njëfarë mënyre e bëjnë më të lehtë punën e mësuesit për të qenë më pranë dhe për t'iu përshtatur më mirë nxënësve të klasës së tij. Përdorimi i fishave të përgatitura nga TV5 Monde do të ndikojë pozitivisht për motivimin, sjelljen dhe angazhimin e nxënësit në mësimin e gjuhës frënge. Përdorimi i këtyre fishave do të përmirësojë ndjeshëm nivelin gjuhësor të nxënësit, do të mund t'i nxitë ata për të qenë më aktivë si edhe do ua bëjë më të lehta e të askueshme njohuritë që përcillen gjatë orës së mësimt.

## **Le français facile avec RFI**

Radio France Internationale që prej vitit 2022 ka krijuar platformën "Le français facile avec RFI", një faqe e re për mësimdhënien e gjuhës frënge me lajme nga bota. Kjo platformë, e rinovuar dhe e përshtatur për celularin, u lejon nxënësve të

përsosin frëngjishten e tyre duke përdorur elementë radiofonikë, veçanërisht prodhimin e saj kryesor, "Journal en français facile", të pasuar me transkriptim të sinkronizuar. Kjo platformë u vjen në ndihmë të huajve që mësojnë gjuhën frënge për të përmirësuar nivelin e tyre të kuptuarit të një materiali të thjeshtë, i ndihmon të aftësohen në leximin e gjuhës frënge dhe shqiptimin e duhur, por edhe në pasurimin e fjalorit me shprehje të përdorimit të përditshëm të gjuhës frënge. "Le français facile avec RFI" ofron gjithashtu ushtrime, të klasifikuara sipas nivelit, objektivit dhe tematikës së trajtuar. Këto aktivitete vetë-korrigjuese i lejojnë përdoruesit të përmirësojnë kuptuarit të një teksti të shprehur me gojë bazuar në ekstrakte autentike të radios. Për mësuesit e frëngjishtes si gjuhë e huaj (FLE), kjo platformë mund të jetë një hapësirë e vlefshme përmes fishave edukative të lidhura me transmetimet RFI të cilat mund t'i punojnë në klasë me nxënësit e tyre.

### **Përdorimi i Framapad-it**

Framapad është një mjet tjetër i cili do mund t'i vijë në ndihmë mësuesit në klasën e FLE-së duke nxitur nxënësit të bashkëpunojnë për të sjellë një tekst në gjuhën frënge duke përdorur secili njohuritë e tij sipas nivelit. Nga njëra anë, nxënësi punon në grup dhe nxitet nga të tjerët, nga ana tjetër, ai nuk e humbet autonominë e tij sepse ky mjet digjital ofron mundësinë e dallimit dhe veçimit të secilit nxënës përmes një kodi ngjyrë. Ky mjet mund të përdoret brenda dhe jashtë klasës gjithashtu. Përdorimi i Framapad-it përveçse është një mjet që mund të tërheqë më mirë nxënësin, është edhe një nxitje për të zhvilluar krijueshmërinë, të shprehurit me shkrim dhe kështu nxënësit dalin nga mënyrat tradicionale të shkruarit e të shprehurit në gjuhë të huaj. Nxënësit mund të nxiten nga njëri-tjetri dhe të zhvillohet një konkurrencë e shëndetshme mes tyre. Mësuesi mund të korrigjojë në kohë reale dhe mund të vlerësojë nxënësin duke e inkurajuar atë për iniciativën e marrë. Përdorimi i Framapad-it mund të jetë shumë i vlefshëm sidomos në shkrimin e projekteve të ndryshme sepse falë kësaj platforme nxënësit e të njëjtit grup mund të punojnë në distancë, të pavarur nga njëri-tjetri dhe njëkohësisht të kenë një bashkëpunim të frytshëm ku mësuesi mbetet në rolin e vëzhguesit, inkurajuesit e vlerësuesit të punës së grupit në tërësi dhe të individit në veçanti.

Përfitimet nga mësimdhënia e mbështetur në mjete digjitale

Fakti që nxënësve u vihen në dispozicion një mori burimesh digjitale u jep mundësinë për të bashkëpunuar, krijuar dhe ndarë njohuritë e tyre me njëri-tjetrin. Mjetet audiovizuale (ekrani interaktiv, tabela digjitale interaktive, etj.) i shtyjnë nxënësit të vizualizojnë mendimet dhe idetë e tyre në mënyra të ndryshme me bashkëmoshatarët e tyre dhe mësuesin. Ruajtja e informacionit nga nxënësit do të përmirësojë falë mundësive të shumta të prezantimit nëpërmjet mjeteve audiovizive. Përpunimi i informacionit të gjeneruar nga këto mënyra të ndryshme

do të lehtësonte përparimin e nxënësve në mësimin e tyre. Përdorimi i mjeteve digjitale të integruara në një mjedis fleksibël bën që të ketë më shumë ndërveprim në klasë dhe një nivel më të lartë të të mësuarit konjitiv. Ekuilibri midis paraqitjes fleksibël dhe një sërë mjetesh digjitale bën të mundur që nxënësit të përparojnë me ritmin e tyre dhe në këtë mënyrë të arrijnë objektiva të ndryshme sipas progresit të tyre.

Në literaturën shkencore janë identifikuar disa përfitime nga ana e mësuesit për përdorimin e mjeteve digjitale në mësimdhënie:

Përdorimi i mjeteve digjitale do të hapë mundësi për qasje të reja pedagogjike në zhvillimin e orës së mësimin. (Delhomme, 2018; Norman et al., 2019; Saunders et al., 2017)

Prania e mjeteve digjitale është një mbështetje për mësuesit për të vlerësuar më shpejt dhe më shpesh të kuptuarin e nxënësve, ndërkohë që rregullojnë ritmin e mësimdhënies sipas progresit të tyre. (Rands dhe Topf, 2017)

Këto hapësira mësimore lejojnë një qasje të diferencuar pedagogjike dhe ndërhyrje të individualizuara, veçanërisht për nxënësit me nevoja të veçanta. (Basye et al., 2015; Johnson et al., 2019)

## **PËRFUNDIME**

Përdorimi i mjeteve të tilla digjitale janë një mundësi e shkëlqyer për të realizuar një pedagogji aktive në klasë, do të shërbejnë si burime për një klasë ku nxënësi do të jetë në qendër të mësimdhënies duke ndërvepruar me klasën dhe mësuesin. Nxënësi do të punojë në një mjedis të këndshëm sepse do të merret parasysh profili i tij, do t'i përshatën materialet si edhe do të përcaktohen strategji për të ndikuar më mirë në përmirësimin e nivelit të tij gjuhësor.

Disa linke që mund të përdoren për një mësimdhënie të mbështetur nga mjete digjitale :

- Sit interneti për mësuesit :  
[enseigner.tv5monde.com](http://enseigner.tv5monde.com)
- Sit interneti për nxënësit:  
[apprendre.tv5monde.com](http://apprendre.tv5monde.com)
- Aplikacion për telefonat celularë :  
[Apprendre le français avec TV5MONDE](http://Apprendre le français avec TV5MONDE)  
Enseigner avec TV5 Monde :  
<https://apprendre.tv5monde.com/fr>
- Le français facile avec RFI – Facebook, Instagram  
<https://www.facebook.com/RFLFrancaisFacile>
- Le français facile avec RFI :  
<https://www.rfi.fr/fr/podcasts/journal-fran%C3%A7ais-facile/>

- Français facile – Exercices :

<https://francaisfacile.rfi.fr/fr/exercices/>

- Exemple : Bidonville – exercice :

francaisfacile.rfi.fr/fr/podcasts/les-mots-de-l-actualite/20230426-bidonville?fbclid=IwAR0oJ27OGRrkziVCBxRiHtPteQavelu3-iHw-dKZruBJPDX1z2ME9Mw1SvY

- Framapad :

<https://framapad.org/abc/fr/>

- Tutoriel Framapad:

<https://www.youtube.com/èatch?v=paZrGhqoTqkhttps://www.youtube.com/èatch?v=x4TuG5yEbp0>

# GJUHËSIA E KORPORAVE: TË MËSUARIT PËRMES WEBSITE-IT DHE PROJEKTIT SI NJË TREGUES NË ZHVILLIMIN E KOMPETENCAVE NË GJUHËN E HUAJ.

**Dr. Juliana Çyfeku**  
[jcyfeku@unkorce.edu.al](mailto:jcyfeku@unkorce.edu.al)

**Dr. Alma Karasali**  
[akarasali@unkorce.edu.al](mailto:akarasali@unkorce.edu.al)

## Hyrje

*Kornizë panoramike e trekëndëshit gjuhësor në përvetësimin e gjuhës angleze:  
Korpus – Projekt – Kompetenca*

Në mësimnxënien e gjuhëve të huaja, përvetësimi i tyre kërkon vëmendje dhe risi në zhvillimin e materialeve mësimore ashtu edhe në zbulimin e burimeve të reja gjuhësore. Me synim lehtësimin edhe rritjen e efikasitetit të këtij procesi gjithëpërfshirës, studimi paraqet se si gjuhësia e korporave (Corpus Linguistics) pajis studentët me 'input' gjuhësor duke reflektuar se si gjuha autentike shfaqet e përdoret në botën reale. Gjuhësia e korporave si edhe zhvillimi i databaseve të mëdha ofrojnë website të shumta të cilat përshtatin nivelin gjuhësor të studentit përmes gamës së gjerë të materialeve që bëjnë një ndryshim nga mësimdhënia tradicionale.

Sipas McEnery & Wilson, (1996 cituar në Baker, 2006) Linguistika e korpusit është "studimi i gjuhës bazuar në shembujt e përdorimit të gjuhës në jetën reale". Në mënyrë të veçantë, Baker (2006) citon më tej se "ndryshe nga qasjet thjesht sasiore ndaj kërkimit, gjuhësia e korpusit përdor tekstet të koduar elektronikisht, duke zbatuar një metodologji më sasiore, për shembull duke përdorur informacionin e frekuencës së përdorimit të fjalëve për dukuritë e fenomeneve të veçanta gjuhësore" (f. 74). Në botën e linguistikës së korpusit, Reppen (2010, fq. 2-63) shpjegon se një korpus është një koleksion i madh parimor i teksteve të natyrshme (të shkruara ose të folura) të ruajtura në mënyrë elektronike. Ai sqaron më tej se "Tekste të natyrshme" përbëjnë gjuhën e nxjerrë nga situatat aktuale gjuhësore, të tilla si bisedat e mësuesve në klasë, bisedat e miqve, takimet specifike në terren, letrat zyrtare/joformale, detyrat e klasës dhe librat; dhe jo nga sondazhet, pyetësorët ose thjesht një gjuhë e sajuar.

Teksti në korpus duhet të përfaqësojë llojin e gjuhës që korpusi synon të targetojë. Për shembull, nëse një korpus duhet të jetë përfaqësues i gjuhës së shkruar atëherë burime të ndryshme të korpusit vënë në dispozicion tekste letrare, prozë akademike, letra biznesi, letra personale, memorandumë zyre..., etj. Në website janë të disponueshme disa korpuse, si: Brown Corpus; Korpusi Kombëtar Britanik

(BNC); Korpusi i Anglishtes Bashkëkohore Amerikane (COCA) dhe Korpusi Ndërkombëtar i Anglishtes (ICE), që me të vërtetë ofrojnë burime të vlefshme dhe informacion se si përdoret gjuha e folur dhe e shkruar në një sërë mjedisesh komunikative (Reppen, 2010). Për analizë të thellë gjuhësore janë krijuar website me mjete specifike të cilat mundësojnë përzgjedhjen e teksteve sipas zhanreve nga gama e gjerë e korpuseve sic shihet nga Figura 1 (Compleat Lextutor), e për pasojë nxitin të mësuarit e gjuhëve të huaja përmes gjuhës autentike në Web.



Figura 1. Faqja zyrtare 'Compleat Lextutor'




Figura 2. Gama e korpuseve në Web

Ajo që mësuesit e gjuhës angleze si gjuhë e huaj duhet të synojnë, është këmbëngulja e 'provimit të diçkaje' nga shkrimet abstrakte dhe shkrim-leximi akademik siç janë paraqitur në korpuset e ndryshme (Figura 2) nëpërmjet regjistrin (register) të synuar; për të bërë të dukshëm efektin që ka në rezultatet e përfuturit të aftësive edhe kompetencave të mësimit të gjuhës angleze. Në terma të tillë, studentët e universitetit mund t'i japin vetes në mënyrë autonome hapësirë, kohën, mjetin edhe vendin për të eksperimentuar aspekte të ndryshme që korpuset ofrojnë. Konkretisht, një korpus ofron dëshmi me shembuj specifikë, për të treguar

frekuencën relative të fjalës kyçe të zgjedhur në terësinë e lokacioneve të fjalëve në rrjet. Vetë studentët janë në gjendje të gjejnë shembuj të fjalëve kyçe të:

- përdorura si: emër, folje, mbiemër, parafjalë, ndajfolje...etj
- veçojnë fjalët që shfaqen para dhe pas fjalës kyçe (d.m.th. bashkëvendosjet e mundshme)
- dallojnë fjalë të tjera të specializuara që shfaqen në ekstrakte
- përcaktojnë veçori të tjera që mund të lidhen me fjalën kyçe (për shembull, parafjalët e përdorura me të, nëse mund të jetë ndonjëherë një emër i përveçëm me shkronjë të madhe, etj.).

Bazuar në këtë risi që vetë ndërkombëtarizimi i të mësuarit të gjuhës angleze kërkon, ky punim synon të nxitë përdorimin efikas të projekteve në mësimin e gjuhës së huaj e jo vetëm por edhe në lëndë të ndryshme të sistemit parauniversitar edhe universitar. Të mësuarit përmes realizimit të projekteve në të gjitha disiplinat, veçanërisht në atë të mësimit të gjuhës së huaj, synon përmirësimin dhe pajisjen e nxënësve me aftësi, elokuencë dhe kompetenca të ndryshme të cilësuar si të nevojshme e të domosdoshme në ditët e sotme e më tej. Përpos kësaj, ato kanë nxitur dhe zhvilluar tek ata një sërë kompetencash si për shembull: gjuhësore dhe komunikative, por edhe ato sociolinguistike dhe strategjike.

## **Metodologjia**

*Metodë bazur tek të dhënat e korpusit (Corpus-based approach)*

*Të mësuarit përmes projektit (Project-based learning)*

*Kompetencat në gjuhën angleze*

Nëpërmjet Corpus Linguistics dhe metodës që ajo zbaton në studimin e gjuhës angleze në diskursin e shkruar dhe të folur, corpus-based/driven approach (metodë e bazuar/e drejtuar mbi bazë të dhënat gjuhësore në rrjet), ofron burime autentike të paraqitjes e gjetjeve të gjuhës në website. Konkretisht, studentët mësojnë si të përdorin gramatikën, sintaksën, e fjalorin e duhur (kompetenca gjuhësore); si të lidhin fjalët, shprehjet dhe fjalitë së bashku për të bashkëbiseduar, folur apo transmetuar një mesazh ...etj (kompetenca komunikative); si të përdorin gjuhën në mënyrë korrekte, cilat janë fjalët dhe shprehjet që i përshtaten temës dhe kontekstit (kompetenca sociolinguistike); dhe si të mësojnë më shumë për gjuhën dhe kontekstin e përdorimit të saj, si të shprehin idetë, kur dhe si të pyesin ...etj (kompetenca strategjike). Ky trekëndësh gjuhësor në gjuhën angleze: Korpus - Projekt - Kompetenca - siguron një mësimdhënie të suksesshme dhe autentike për mësimin e gjuhës së huaj (angleze ne rastin studimor). Si të tilla ato duhet të trajtohen si elementë të integruar, të ndërvarur dhe të pandashëm të gjuhës. Integrimi i tyre veçanërisht në metodologjinë e sotme të gjuhës angleze shihet si një domosdoshmëri që ndihmon studentët të zhvillojnë kompetencat e tyre gjuhësore dhe komunikative, i motivon ata të mësojnë më mirë duke rritur dinamizmin e orëve të mësimit, duke krijuar hapësirë gjithëpërfshirëse në procesin

mësimor; siguron mësimdhënie edhe mësimnxënie në situata reale komunikimi përtej ambjenteve mësimore. "Suksesi i vërtetë në mësimdhënie dhe mësimnxënie e gjuhës është kur nxënësit arrijnë të komunikojnë në gjuhë angleze, brenda dhe jashtë klasës" (Davies and Pearse, 2000, f. 99).

Transmetimi i dijes i bazuar në projekte (PBL) rezulton në edukimin e sotëm si një model që plotëson nevojat e mësuesve dhe të nxënësve në mësimdhënie dhe mësimnxënie e një gjuhe të huaj në mënyrë efektive. Mësimi i bazuar në projekt nxit mësimdhënie dhe të mësuarit në përputhje me aftësitë e të mësuarit të gjuhës së huaj: të folurit, të dëgjuarit, të lexuarit edhe të shkruarit; angazhon studentët në procesin e të mësuarit; motivon dhe zhvillon të menduarit kritik edhe krijuese tek ta, edhe në një nivel më të konsoliduar zhvillon kompetencat duke qenë kështu një tregues i matshëm edhe i arritshëm në përmbylljen e një kursi praktik, teorik ose i kombinuar në disiplina të ndryshme gjuhësore.

Projekti është tashmë prej kohësh pjesë e kërkesave edhe objektivave lëndore të gjithsecilit nga ne jo vetëm në ciklin e studimeve në arsimin e lartë por edhe në atë parauniversitar. Termi projekt është një kriter matës i njohurive, aftësive edhe kompetencave të nxënësve duke nisur që nga (arsimi fillor, arsimi i mesëm i ulët; arsimi i mesëm i lartë si dhe duke u thelluar më tej në arsimin universitar). Tashmë 'projekti' është pjesë e kurrikulave të zhvilluara në këto hallka arsimore me bazë zhvillimin e kompetencave në procesin e mësimnxënies.

Ajo që ky studim thekson është se nxënësit apo studentët janë të familjarizuar me termin projekt, duke e pasur atë si një prej veprimtarive kryesore që përmbyll ciklin e studimeve në një nivel të caktuar, e që ka vlerë në vlerësimin e vazhduar të tyre por që konsiderohet edhe vendimtar në përmbylljen lëndore në të gjitha hallkat arsimore të lartpërmendura.

Gjerësisht, projekti është cilësuar si një formë vlerësimi në kontekstin akademik edhe në kushte normale të mësimdhënies por edhe të mësimnxënies specifikisht tek ato lëndë të tipik teoriko-praktik. Përdorimi i tij në edukim synon prezantimin formal, të stukturuar, të orientuar në gjithë-përfshirjen e studentëve; mundëson aftësinë unike të gjithsecilit për të zhvilluar tek ata kompetencat për të ndërtuar njohuri duke gjeneruar në projektet: interesat e tyre, dallimet individuale dhe origjinalitetin krijues të gjithsecilit.

Përmes këtyre projekteve finale ata bëjnë lidhjen midis njohurive të reja dhe njohurive të tyre ekzistuese (theksoj faktin që ata kanë punuar në grupe pune ose dhe individuale në nivelet e arsimit parauniversitar) dhe për rrjedhojë janë në gjendje t'i zbatojnë ato në mjedise të tjera të ngjashme duke iu atribuar disa kritere me specifike për realizimin e tyre në nivel akademik; për tu identifikuar me nivelin e një kërkuesi shkencor që përpos dijes së marrë, kërkon e heton përtej saj për të shpjeguar dukuri të jetës reale.

Për rrjedhojë ata mësojnë në një kontekst kuptimplotë (referuar lëndës që studjojnë 'Korpora në Gjuhësinë e zbatuar',) e duke finalizuar këtë proces në krijimin e një



produkti përfundimtar. Bazuar në idenë se studentët fitojnë njohuri, aftësi ose kompetenca duke përjetuar dhe zgjidhur çështje dhe probleme të botës reale, mësimi i bazuar në projekt (PBL) është njohur si efektiv dhe i frytshëm në arsimin e shekullit 21. Një numër i madh studimesh mbi PBL janë kryer në shkallë globale (Lam, 2011). Simpson (2011) pohon se PBL nuk është një qasje e re në arsimin e përgjithshëm. Sipas Beckett (2006) PBL mund të gjurmohet që nga mesi i viteve 1800 ku u krijua për herë të parë nga David Snedden i cili jepte lëndët shkencore në degën e bujqësisë amerikane. Më vonë, në fillim të viteve 1900, PBL u zhvillua më tej nga William Heard Kilpatrick, studenti i John Dew, dhe u përqendrua në nevojën që nxënësit të kenë një aktivitet të qëllimshëm (Beckett, 2006) Kryesisht, PBL u zbatua gjerësisht në edukimin shkencor (Kalvu, 2015). PBL është përfshirë gjithashtu edhe në arsimin gjuhësor së bashku me një interes të shtuar për të mësuarit me në qendër studentin (student-centered), të mësuarit autonom dhe të mësuarit në bashkëpunim (Hedge, 1993). Termi "projekt" i përdorur në kontekstin e gjuhës angleze si gjuhë e huaj, u propozua nga Fried-Booth (1986, fq.8) duke treguar që detyrat gjuhësore lindin natyrshëm nga vetë projekti, "duke u zhvilluar në mënyrë kumulative në përgjigje të një objektivit themelor, domethënë të projektit." Për më tepër Hedge (1993) i specifikon projektet si detyra të zgjeruara të cilat zakonisht integrojnë aftësitë gjuhësore me anë të një numri aktivitetesh.

### **Gjuhësia e korporave dhe të mësuarit përmes projektit (PBL)**

Realisht një sërë aktivitetesh u kombinuan nga studentët në lëndën akademike 'Korpora në Gjuhësinë e zbatuar', që zhvillohet në Kursin II, Master Mesuesi në Gjuhë Angleze në konkretizimin e projektit përmbyllës së lëndës; puna individuale e tyre u orientua drejt një qëllimi unik për të gjithë ata në një proces që përfshiu: planifikimin, mbledhjen e informacionit përmes literaturës së prezantuar tek ta gjatë zhvillimit të lëndës, dëgjimit të materialeve edhe modeleve praktike të vetë lëndës të gjendura në internet, ku përmes vëzhgimit e diskutimit në grup të informacionit të gjetur ata gjetën zgjidhje rreth problemeve gjuhësore që vete ata parashtuan në projektet e tyre, përmes raportimeve me gojë dhe me shkrim; dhe kështu duke konkluduar në prezantimin final bazuar mbi këto hapa konkrete të mbarëvajtjes së tij si edhe kriteret me bazë: dijen lëndore së bashku me cilësitë që duhet të ketë prezantimi përballë audiencës (pedagogu edhe studentët e kursit lëndor).

Stoller (2006) liston këto kritere bazë për të arritur efikasitetin e të mësuarit përmes projektit:

- të jetë i orientuar nga procesi dhe i orientuar nga produkti
- studentët duhet të kenë fjalën e tyre në formësimin e procesit dhe produktit
- duhet të shtrihet përtej një periudhe të vetme në klasë
- duhet të inkurajojë aftësinë e studentit përmes integritetit të tyre

- duhet t'u japin studentëve mbështetje si në mësimin e gjuhës ashtu edhe në atë të përbajtjes
- studentët duhet të punojnë në grupe / çifte / ekepe si dhe të pavarur
- duhet të kërkojë që studentët të jenë përgjegjës për mësimin e tyre në gjuhën e synuar
- duhet të lejojë kohë për t'u përqëndruar në gjuhë dhe mësimdhënie të drejtpërdrejtë nëse është e nevojshme
- duhet të rezultojë në një produkt përfundimtar, të prekshëm
- duhet të përfundojë me reflektimin e studentëve si për procesin ashtu edhe për produktin final.

"Projektet" që këta studentë realizuan u përshkruan si "detyra komplekse, të bazuara në pyetje ose probleme sfiduese në mësimin e gjuhës angleze të cilat ata i pasqyruan përmes aktiviteteve e detyrave konkrete. Kjo formë prezantimi u cilësua si një formë e re, integruese, ndërvepruese edhe sfiduese për ta, kjo e fundit gjeneruar nga detyra me bazë informacion e marrë edhe përpunuar nga programe kompjuterike në internet. Risi për ta ishte prezantimi në kohë reale; ashtu siç ishte i tillë edhe prezantimi i lëndës përmes platformës Teams në periudhën e pandemisë globale me të cilën ata së bashku bashkëpunuan lehtësisht në shkëmbimin e informacionit dhe vlerësimit final. Përmes kësaj platforme edhe demonstrimit të njohurive përmes projektit u mundësua shndërrimi i klasës virtuale në një laborator virtual të mëimit të gjuhës angleze; sfidë kjo që në vetvete hasi vështirësi/probleme të tipit:

1. Mësim online; jo të gjithë ishin prezentë ose aktivë në mësimin virtual; për arsye teknike, shëndetsore, mungesë e komunikimit të drejtpërdrejtë që rrit ndjenjën e përgjegjësisë tek studenti, motivimin ndaj lëndës..etj.
2. Vështirësi në kryerjen e punës në grup në internet,
3. Komunikimi online midis studentëve i cili rezultoi jo totalisht ndërveprues në natyrë edhe jo reciprok në tërësi, ndërmjet aktorëve: pedagog-student,
4. Vështirësi në dëgjimin edhe diskutimin integruar të studentëve për të dhënë vlerësimet e tyre për shkak të problemeve teknike të internetit, fonisë, përpilimit të dokumentit ..etj.

Pavarësisht këtyre problemeve teknike, synimi përfundimtar në përmbylljen lëndore ishte të orientonte studentët në hartimin e planeve mësimore ndryshe nga formatet e bëra më parë (risi kjo specifike e vetë lëndës), me konkretizim praktik në rrjet zgjidhjen e problemeve, vendimmarrjen ose aktivitetet huluntuese gjuhësore; duke u dhënë në këtë mënyrë mundësinë për të punuar relativisht në mënyrë autonome për periudha të caktuara kohore; dhe duke kulmuar në produkte dhe prezantime realiste që ata bënë konkretisht në përmbylljen e lëndës akademike 'Korpora në Gjuhësinë e zbatuar'.

*Cilat janë karakteristikat kryesore të realizimit të projektit si edhe të përmbylljes lëndore përmes tij si formë vlerësimi?*

Përdorimi i projektit si formë vlerësimi përmbyllëse në lëndën akademike 'Korporat dhe Gjuhësia e zbatuar' rezultoi efektiv në eksplorimin dhe përvetësimin e gjuhës autentike në web në qasje të plotë me pohimet hulumtuese të Simpson (2011) në të cilën specifikisht, studentët e gjuhës angleze:

- eksploran burime të reja dhe bashkëkohore në Web;
- krijuan e demonstrojnë një sërë veprimtarish mësimore me në qendër studentin, përmes së cilës ata planifikuan, plotësuan dhe paraqitën projektin dhe interesin e tyre në përputhje me objektivat lëndore;
- parashtruan pyetje sfiduese, probleme ose tema me interes për/tek studentët të cilat ishin qendra e projektit dhe procesit të të nxënimit;
- patën një mundësi për të ndarë burimet, idetë dhe ekspertizën gjatë gjithë procesit në klasën hibride;
- paraqitën aktivitete praktike nga përdorimi i burimeve dhe teknologjive autentike;
- krijuan edhe pse virtual, një mjedis bashkëpunimi për të mësuar, sesa një mjedis konkurrues;
- dhe përdorën, demonstrojnë një larmi aftësish siç janë aftësitë shoqërore dhe aftësitë kërkuese.

*Cilat janë rezultatet e përftuara në lëndën studimore nga gërshetimi i të dhënave gjuhësore përmes website edhe realizimit të projektit si përmbyllës lëndor?*

Projekti përmbyllës mundësoi tek studentët:

- ✓ Zhvillimin dhe përmirësimin e aftësive gjuhësore deri në rritjen personale të studentëve.
- ✓ Integrimin e katër aftësive gjuhësore: të folurit, të dëgjuarit, të lexuarit dhe të shkruarit.
- ✓ Përdorimin e një shumëllojshmërie aktiviteteve në detyrat, aktivitetet e planet mësimore që ata prezantuan në auditor.
- ✓ Hapësirën të "riciklojnë gjuhën dhe aftësitë e njohura në një kontekst relativisht natyror" (mundësi kjo edhe për vetë natyrën praktike edhe shumëllojshmërinë e detyrave e ushtrimeve autentike që karakterizon vetë lëndën).

Aktivitetet autentike u referohen aktiviteteve të krijuara nga vetë ata; bazuar nga modele e udhëzimet e dhëna përmes leksioneve si edhe modelet konkrete gjuhësore në rrjet duke zhvilluar tek ta aftësitë e të menduarit në mënyre inteligjente për zgjidhjen e problemeve/çështjeve gjuhësore, leksikore, të cilat ata do ti praktikojnë në kontekste jashtë auditorit (praktikën profesionale) duke nxitur në këtë mënyrë të mësuarit autonom në gjuhën e huaj.

Për më tepër ata zhvilluan kompetenca të përgjithshme, duke përfshirë në këto të fundit njohuri deklarative dhe socio-kulturore, ndërgjegjësim dhe aftësi

ndërkulturore të studentit përfshirë në to. Ndërsa kompetencat gjuhësore komunikuese e fuqizuan atë duke përdorur mjete të veçanta gjuhësore, përfshire aftësitë gjuhësore, sociolinguistike dhe pragmatike/stategjike (aftësi këto që u evidentuan në materialet autentike që ata realizuan në projekte grupi e në fund individuale përmes gjuhës autentike të vetë lëndës së korporave).

1. *Kompetenca gramatikore*: Ajo mishëron aspektet teorike të gjuhës, me fjalë të tjera, njohuritë e gjuhës të evidentuara nga Noah Chomsky (1965). Siç mund të mbahet mend, termi kompetencë gramatikore ishte paramenduar gjithashtu me 'Pajisjen e Blerjes së Gjuhës' (LAD), një kuti e zezë, një aftësi mendore instiktive që i mundëson foshnjës të marrë dhe të prodhojë gjuhë në një mënyrë të rregulluar, kompetencën gramatikore.

2. *Kompetenca sociolinguistike*: Kjo kompetencë ka të bëjë me bashkëveprimin njerëzor në kontekste natyrore; thëniet, pasi ato krijohen dhe nënkuptohen në kontekste të ndryshme sociokulturore. Kompetenca socio-linguistike është mjaft e rëndësishme pasi është e mirëfilltë për një komunikim real.

3. *Kompetenca e ligjërimit*: Kompetenca e ligjërimit mishëron aftësitë dhe kompetencën për të prodhuar gjuhë në nivelin e fjalisë dhe tekstit duke përbushur standardet e kohezionit dhe koherencës.

4. *Kompetenca strategjike*: Kompetenca strategjike përfshin strategjitë e komunikimit të drejtpërdrejtë për të siguruar efikasitet, efektivitet dhe rrjedhshmëri në ligjërime.

## **PËRFUNDIME**

Mësimi dhe përvetësimi i gjuhës së huaj bazuar në projekt është i rëndësishëm për nevojat e studentëve tanë dhe për këtë arsye është motivues. Kjo jo vetëm që i ndihmon studentët të përvetësojnë një gjuhë në mënyrë më efektive dhe mundëson konsolidimin e përmbajtjes specifike, por gjithashtu inkurajon studentët që të jenë të vetëdijshëm për mënyrën e të mësuarit (vetëdija metakognitive). Ajo inkurajon një mënyrë gjithëpërfshirëse të mësuarit në të cilën praktikohen aftësitë shoqërore dhe njohëse. Përfitimet e të mësuarit përmes projektit ku gërshetohen më së miri dy metoda bashkëkohore të mësimit të gjuhës angleze: corpus-based dhe project-based approach përmes website (Compleat Lextutor) shkojnë përtej mureve të klasës dhe i vendos studentët në një rrugë drejt të mësuarit gjatë gjithë jetës.

Arsyeja për zgjedhjen e projektit si formë vlerësimi në përmbjlljen lëndore përpos faktit të mësimit virtual/hibrid diktuar si mënyrë e re mësimi e vlerësimi në situata emergjence globale (Pandemia 19): qëndron se kjo e fundit maksimizoi në procesin mësimor përfitime të tilla si: angazhim, bashkëpunim, krijimtari, motivim, autonomi dhe pavarësi nga ana e studentëve.

Duke përforcuar bindshëm karakteristikat e implementimit të projektit në mësimdhënien e mësimnxënien e gjuhës së huaj që vijojnë në rend global: të mësuarit në bashkëpunim, me në qendër studentin, të mësuarit gjatë gjithë jetës, të

mësuarit e vetë-drejtuar, duke zhvilluar te këta të fundit cilësi positive si atë të motivimit, autonomisë dhe krijimtarisë, të cilat janë të përshtatshme, të frytshme e të matshme si tregues përvetësimi i aftësive e kompetencave veçanërisht në mësimin e gjuhës angleze.

Gjithashtu projekti mundësoi që studentët të ndiheshin dhe realisht të ishin të pavarur në procesin e mësimnxënies pasi ata ishin vetë përgjegjës për çfarë përzgjedhën dhe paraqitën si produkt të projektit në përshtatje me 'aftësitë, stilet dhe preferencat e tyre' (Skehan, 1998: 273).

Ky rast studimor i mësimnxënies bazuar në projekt tregoi implikime pedagogjike të qarta por edhe konkrete. Njohja e metodave moderne të mësimdhënies dhe mësimnxënies, udhëzimi kundrejt tyre, dhe gatishmëria për të eksperimentuar me to shërbejnë si sfida që në përmbyllje ndihmojnë mësuesin (pavarësisht lëndës mësimore) dhe nxënësit/studentët të arrijnë qëllimet e edukimit në çdo nivel universitar edhe parauniversitar.

## **BIBLIOGRAFI**

- Baker, P. (2006). *Using Corpora for Discourse Analysis*. London: Continuum
- Beckett, G.H., (2006). *Project-based second and foreign language education: Past, present, and future*. Greenwich, CT: Information Age Publishing
- Cobb, T. (2000). *The Compleat Lexical Tutor* [Website], developed by Tom Cobb of University of Montreal, Canada. Available at: <http://www.lextutor.ca/conc/eng/>.
- Davies, P. & Pearse, E. (2002). *Success in English Teaching*. Shanghai Foreign Language Education Press. p. 99.
- Fried-Booth, D. L. (1986). *Project work*. (1st ed.). Oxford: Oxford University Press
- Hedge, T. (1993). *Key Concepts in ELT: Project work*. *ELT Journal*, (47)3, 275-277. <http://dx.doi.org/10.1093/elt/47.3.275>
- Kalvu, A. (2015). *Project-based learning assessment methods comparison in undergraduate EFL classes*. *International Journal of Social Sciences & Educational Studies*, 1(4), p.49-53.
- Reppen, R. (2010). *Using Corpora in the Language Classroom*. In J. C. Richards, (Eds.) Cambridge: Cambridge University Press, pp 2-63.
- Simpson, J. (2011). *Integrating project-based learning in an English language tourism classroom in a Thai university institution*. (Doctoral Thesis), Australian Catholic University.
- Skehan, P. (1998). *A cognitive approach to language learning*. Oxford University Press.
- Stoller, F. (2006). *Establishing a theoretical foundation for project-based learning in second and foreign language contexts*. In Beckett, G., H. & P. C. Miller (Eds.), *Project-Based Second and Foreign Language education: past, present, and future* (pp. 19-40). Greenwich, Connecticut: Information Age Publishing.

# PËRDORIME PRAKTIKE TË VLERËSIMIT NËPËRMJET MJETEVE TIK

**Dr. Lorena Robo**  
**l.rob@yaho.com**

## **Hyrje**

Përdorimi i TIK-ut në ditët e sotme ka zhvendosur vëmendjen e rolit të mësuesit nga aktor i vetëm kryesor në rolin e mësimdhënies në atë të menaxherit të klasës për të arritur një performancë më të mirë të aktorëve të saj, po kështu kanë ndryshuar edhe rolet e nxënësve në klasë. Vihet re interesi i madh që nxënësit kanë në orët ku përdoret TIK duke marrë pjesë aktive në mësim, janë më hulumtues, janë të etur për të sjellë risi në mësim dhe zhviten disa herë më shumë. Si rezultat i kësaj lind nevoja edhe e zotërimit të platformave dhe metodave bashkëkohore për vlerësimin online të detyrave të shtëpisë, testeve, provimeve, projekteve etj. Periudha e Covid-19 vuri mësuesit dhe nxënësit në një sfidë të tillë ku për hir të së vërtetës secili duhet t'i përgjigjej nevojës së kohës në mungesë të auditoreve dhe klasave fizike. Sot mësimdhënia online nuk shihet më si fenomen aktrakt, i paprekur dhe i pakonceptueshëm por si një sfidë që të gjithë mësuesit ditët ta përballin me profesionalizëm, dinjitet dhe vendosmëri.

Platformat e mësimdhënies online të përdorura gjatë orës së mësimin në nivelin universitar dhe parauniversitar variojnë nga Moodle, Google Classroom, Microsoft Teams, Zoom, etj. Qëllimi i këtij punimi është të evidentojë platformat kryesorë të përdorura për vlerësimin e nxënësve gjatë orës së mësimin në bazë të trajnimit të realizuar në datë 19-20 prill 2023 me temë “Vlerësimi nëpërmjet mjeteve digjitale në arsim” në kuadër të projektit DigiCom të financuar nga AKSHI. Pjesëmarrësit ishin 35 mësues nga shkolla 9-vjeçare dhe të mesme të qytetit të Korçës. Në përfundim të trajnimit dy ditor mësuesit dorëzuan detyra praktike të një ore mësimi të përdorimit të platformave të shpjguara në trajnim.

## **Përdorime praktike të platformave online të përdorura në vlerësim**

Disa nga platformat online të përdorura më gjerë në procesin e vlerësimit janë:


- Quizlet
- Quizbean
- Socrative
- Kahoot!
- TypeForm
- Survey Anyplace
- iSpring Suite
- Google Forms
- Microsoft Forms
- Skolera

- iSpring Suite
- Qorrect for online Assessments

Disa nga platformat kryesore që mësuesit u njohën gjatë trajnimit të zhvilluar nga Departamenti i Gjuhës Angleze, Universiteti “Fan S. Noli” në kuadër të projektit DigiCom të fituar me AKSHI-n do të paraqiten më konkretisht si më poshtë:

Quizbean (<http://quizbean.com>):



- Hartimin e shpejtë të testeve.
- Renditjen e pyetjeve në mënyrë rastësore
- Përdoret si aktivitet brainstorming/parapergatitor ose për të testuar njohuritë e mëparshme.
- Nxenesit ose studentët mund të krijojnë kuizet për bashkëmoshatarët e tyre.
- Vendosjen e imazheve të ndryshme në pyetjet e kuizit.
- Platformë mjaft efikase për vlerësimin e vazhduar të nxënësve
- Nxënësit mund të bëjnë kuize ose të logohen shumë lehtë
- Metodë analitike për nxjerrjen e rezultateve
- Shpërndan rezultatet nëpërmjet mediave sociale dhe email-it
- Lejon vendosjen e afatit të perfundimit të kuizit



Quizlet (<http://quizlet.com>)

- Platformë pa pagese që mund të shfrytëzohet për vlerësimin e nxënësve
- Mund të krijohen teste për studimin e kurrikulave ose dosje studimore online
- Siguron 4 tipe aktivitetesh duke përfshirë modele testi:
  - flash cards
  - Gërmëzimi i fjalëve
  - Testimi
  - Space Race (lojë)
  - Scatter (lojë)


- mund t'u dergojne email ose të ftojne nxënësit të lidhen nëpërmjet një linku
- Bashkangjit ose shton aktivitete në një ëbsite ose nje blog
- metodë shume efikase për mesimin e fjalorit. Gjithashtu mund të përzgjidhen gjuhët që dëshiron të kërkojsh



Google Suite (Google Docs, Google Slides, Google Forms) - <https://docs.google.com>


- Krijon pyetje për të vlerësuar nxënësit e tipeve të ndryshme
- Ben pikëzimin e pyetjeve
- Vendos përgjigjen e saktë për vlerësim automatik nga sistemi
- Siguron studentët me feedback të menjëhershëm
- Jep rezultatet e nxënësve në mënyrë të përmbledhur ose individuale
- Siguron tabela ose grafike të rezultateve të nxënësve për analizë më të shpejtë të nivelit të arritjes së nxënësit
- Ketu mund të krijohen quize, teste, etj.







**Formative (<https://app.formative.com/>)**

Njësoj si në platformat e tjera edhe në Formative mësuesi mund të krijojë kuize, mund të zgjedhë rradhën e pyetjeve në ushtrimet me alternative, mund të krijojë një rend të ndryshëm të shfaqjes së pyetjeve për secilin nxënës, kjo eviton kopjimin dhe përgjigjet e njëjta të tyre. Mësuesi mund të rregullojë pikët e përgjigjeve të pyetjeve edhe nëse ushtrimi eliminon automatikisht pikët. Për secilën pyetje mësuesi ka hapësirë të vendosë udhëzimet përkatëse.



**Socrative (<https://socrative.com>)**

- Platformë e përdorur për të hartuar teste dhe provime
- platformë e bazuar mbi lojën
- ndihmon mësuesit të menaxhojnë procesin e vlerësimit tek nxënësit dhe të udhëheqin progresin e tyre
- përdoret për të kryer aktivitete të ndryshme si kuize, pyetësorë dhe aktivitete në skuader. Tek platforma Socrative mund të shtosh apo bashkangjitesh për secilën pyetje figura, grafikë etj, si paraqitja grafike më poshtë. Platforma lejon edhe renditjen e rezultateve të testit të studentëve të eksportuara në faqe exceli në mënyrë të përmbledhur për të gjithë studentët, krijimi i faqeve të veçanta për secilin student, çelësin e përgjigjeve të pyetjeve të ushtrimeve, etj.



## PËRFUNDIME

Synimi i këtij punimi ishte paraqitja e përdorimeve praktike të vlerësimit të nxënësve nëpërmjet përdorimit të mjeteve TIK. Gjatë prezantimit të platformave dhe mjeteve të duhura për realizimin e procesit të vlerësimit, pjesëmarrësit u njohën me avantazhet dhe disavantazhet e secilës prej platformave. Përdorimi i TIK në arsimin universitar dhe parauniversitar është nevojë e domozdoshme i cili ka ndryshuar rrënjësisht nevojat, praktikat dhe procedurat e sistemit arsimor në këto njëzet vitet e fundit. Aftësia për të përdorur teknologjinë e informacionit është një nga parimet bazë dhe themelore të arsimit sot në botë. Në të gjitha vendet Europiane TIK është bërë nevojë e padiskutueshme e shoqërisë dhe edukimit të brezave të rinj. Të kuptuarit e TIK dhe zotërimi i koncepteve dhe shkathtësive themelore të tij konsiderohet sot si parimi bazë mbi të cilin duhet të bazohet mësimdhënia në klasë. Përdorimi i tij është në përpjestim të drejtë me rritjen e rezultateve në mësimnxënie. Nxënësit kanë vijueshmëri dhe performancë më të mirë kur TIK integrohet me procesin mësimor, po kështu edhe kur vlerësimi i arritjeve të tyre realizohet nëpërmjet platformave online.

Gjatë trajnimit mësuesit u njohën me avantazhet dhe disavantazhet e përdorimit të secilës prej platformave online në fund të së cilit u arritën këto përfundime:

1. Sistem i shpejtë vlerësimi, kërkon pak kohë dhe mund të realizohet edhe nga shtëpia, nevojitet një kompjuter programi përkatës dhe internet.
2. Rezultatet e testit merren në kohë reale pa pritur ditë ose javë për korrigjimin e tyre nga mësuesi.
3. Testi mund të ngarkohet në platformë ku mësuesi përcakton kohën kur do të hapet testi nga programi dhe kohën kur do të mbarojë.
4. Mësuesi përcakton rradhën e ushtrimeve që do të shfaqet për secilin nxënës brenda të njëjtit test, për të shmangur kopjimin e përgjigjeve nga ana e tyre.
5. Rregullon ose ndryshon pikët e përgjigjes së ushtrimit
6. Mësuesi nuk merr pjesë aktive gjatë testit
7. I shpejtë dhe i thjeshtë për mësuesin dhe nxënësin.
8. Është më interesant dhe zbatimës për nxënësit.
9. Nxënësi merr feedback të menjëhershëm për statusin e tij të të mësuarit, shikon mangësitë dhe dobësitë e tij dhe nevojën për përmirësim. Platforma jep përgjigjen e saktë.
10. Rrit përqëndrimin, të kuptuarit dhe ruajtjen e informacionit.
11. TIK mund të përdoret për të përmirësuar cilësinë e të mësuarit.
12. Testet ngarkohen në platforma ose ëbsite për një përdorim më të gjerë, nga nxënës dhe shkolla të ndryshme.
13. Nxënësit kanë ndjenjën e kontrollit mbi të mësuarit e tyre.
14. Këto platforma përmirësojnë angazhimin e nxënësve në materialin e dhënë.

Ky punim kishte për qëllim evidentimin dhe njohjen e platformave kryesore nga ana e mësuesit për vlerësimin e rezultateve të të nxënit, hartimin e testeve, projekteve, detyrave të kursit dhe korrigjimin automatik të tyre. Procesi i vlerësimit duhet parë jo si një fenomen i mërzitshëm dhe stresues për mësuesin. Ofrimi dhe njohja me mjete dhe platforma kompjuterike për të lehtësuar punën e lodhshme dhe stresuese do të ishte një nga përpjekjet më efikase dhe dobiprurëse në procesim e arsimit në ditët e sotme.

## **BIBLIOGRAFIA**

<http://quizbean.com/>  
<https://docs.google.com/>  
<https://app.formative.com/>  
<https://socrative.com/>

# ROLI I MJEDISEVE VIRTUALE NE MESIMDHENIEN E KOMPETENCES DEGJIMORE NE GJUHEN E HUAJ – INTEGRIMI I WEBSITE-IT

**Dr.OLSA PEMA**

[olsa.pema@yahoo.com](mailto:olsa.pema@yahoo.com)

## **Hyrje**

Studimet tregojnë se rreth 50% e kohës së komunikimit shpenzohet duke dëgjuar (Gilman dhe Moody, 1984). Në fakt, dëgjimi renditet ndër aftësitë më të rëndësishme që mund të fitojmë gjatë jetës pasi u paraprin aftësive të tjera. Përmes dëgjimit, në të vërtetë, arrijmë të kuptojmë tjetrin, të pasurojmë jetën si dhe të përvetësojmë informacion të rëndësishëm për përvojën tonë. E cilësuar deri vonë si aftësi komplekse apo e vështirë për t'u përvetësuar, studimet për zhvillimin e kësaj makroshprehie në mësimdhënien e gjuhëve të huaja janë lënë pas dore për dekada të tëra. Nga ana tjetër, tashmë është bërë i njohur fakti se nxënësit që mësojnë një gjuhë të huaj, përveç njohurive gjuhësore, duhet të pajisen edhe me shprehitë për ta përdorur gjuhën në mënyrën e duhur nga pikpamja shoqërore e kulturore. Ky konceptim i gjerë i mësimdhënies së gjuhëve të huaja përbën edhe risinë themelore të KEPR, ku theksohet rëndësia e “ndërgjegjies dhe shprehive ndërkulturore” gjatë arsimimit në gjuhën e huaj, me fjalë të tjera, nevoja për të zhvilluar tek nxënësit vetëndërgjegjen kulturore dhe, me tej, aftësinë për të kapërcyer muret e kulturës së tyre dhe për të komunikuar me sukses me individë të tjerë me prejardhje të ndryshme kulturore-gjuhësore.

Në kushtet e masivizimit të internetit në shoqërinë e mijëvjeçarit të ri, vetë rrjeti shihet si një platformë për ta promovuar më tej MNGJH efektive duke krijuar një mjedis ideal për nxitjen e shprehive komunikative e kulturore si dhe aplikime të larmishme në kontekste të ndryshme.

## **Qëllimi i punimit**

Përvoja e sjellë në këtë punim është pjesë e një kuadri më të gjerë të një projekti madhor të titulluar “English for the Net Generation” (“Anglishtja për Brezin e Internetit”) – një iniciativë e imja e bërë realitet me studentë të kursit të parë, dega gjuhë angleze, Universiteti “Fan S. Noli” Korcë dhe më tej i rifunksionalizuar në kuadër të trajnimeve për projektin DIGCOMP. Kjo iniciativë në thelb pati çeljen e një website-i për zhvillimin e mëtejshëm të shprehive gjuhësore në një mjedis virtual në lëndët Komunikim dhe Qytetërim Amerikan si një burim mbështetës për informacion e praktikë gjuhësore, promovues i shprehive gjuhësore e kulturore, për zhvillimin e të cilave duket se klasa përbën një mjedis të pamjaftueshëm.

Në fokus të kësaj analize do të jetë pikërisht shqyrtimi i vlefshmërisë së kurrikulës dëgjimore në mjedisin virtual të website-it në funksion të nxitjes së

kompetencave dëgjimore e në gjuhën angleze duke u mbështetur te vendi që teoritë bashkëkohore i caktojnë teknologjisë. Më konkretisht:

Sa u përmbahet mësimdhënia virtuale përmes website-it parimeve universale për një dëgjim të suksesshëm si dhe a përligjet integrimi i ketij mjeti në mësimdhënien e gjuhëve të huaja nga teoritë bashkëkohore të të nxënit?

### **Metodologjia dhe instrumentat**

Fondi i marrë në shqyrtim përbëhet prej një cikli të plotë programi dëgjimi (gjithsej 14 tekste) në nivelin e parë të përparuar (“First Certificate”) të gjuhës i vënë në zbatim përgjatë projektit.

Rezultatet e paraqitura në këtë studim mbështeten, së pari, në shqyrtimin me karakter argumentativ - përshkrimor të materialeve dëgjimore për evidentimin e shkallës së aktualizimit të parimeve bashkëkohore pedagogjike në to, kusht ky i domosdoshëm për të siguruar standardet e nevojshme për veprimtari të suksesshme në zhvillimin e dëgjimit në gjuhën e huaj.

### **Drejtimi 1. Teoritë e të nxënit të gjuhëve të huaja dhe vendi që ato u caktojnë teknologjive të internetit**

Diskutimet mbi teknologjitë e internetit nuk do të ishin të plota pa një vështrim të përgjithshëm mbi teoritë e të nxënit të gjuhës së huaj, kjo për arsye se teori të ndryshme i japin jo të njëjtën rëndësi rolit të mësimdhënies praktike dhe, nënkuptohet, internetit në klasë e përtej saj. Qëllimi i pasqyrës së mëposhtme, pra, nuk është thjesht të sqarojmë në detaje teoritë bashkëkohore të të nxënit të gjuhës së huaj, por të tregojmë se roli i mësimdhënies praktike, rrjedhimisht, edhe i përdorimit të TIK-ut në të, merr vlerë jo të njëjtë në teori të ndryshme. Për më tepër, mësimdhënësve të gjuhës u nevojitet një bagazh teorik paraprak për të përcaktuar se kur një mjet mund t’i vijë realisht në ndihmë zhvillimit gjuhësor të nxënësit.

Në literaturën bashkëkohore mbi të nxënë të gjuhës së huaj shtjellohen dy kahe të ndryshme modelesh jo krejt pa lidhje me njëri-tjetrin. Njëri është modeli psikolinguistik dhe tjetri modeli sociolinguistik. Literatura dhe praktikat e sotme pedagogjike në gjuhët e huaja dhe mësimdhënien në përgjithësi priren t’i mëshojnë këtij të fundit. Më poshtë po analizojmë më në detaj çfarë përfaqësojnë e si përkthehen në MNGJH këto qasje, për të njohur më mirë hapësirat dhe vendin që mund e duhet të zërë TIK-u në procesin mësimor.

Këndvështrimi psikolinguistik i ka bazat tek teoria ineiste e Chomsky-t mbi natyrën e gjuhës, e cila ka revolucionarizuar fushën e gjuhësisë me postulatit e famshëm fëmijët lindin me predispozitën për të mësuar gjuhë, duke qenë të pajisur me një mekanizëm të posaçëm mendor për përvetësimin e gjuhës. Duke u ekspozuar ndaj një input-i të pasur gjuhësor të karakterizuar nga përdorimi si duhet i fjalive të mirëformuara prej folësve amtarë, fëmija zhvillon gjithë strukturat

e tjera specifike gjuhësore. Performanca gjuhësore, sipas Chomsky-t, është një veprimtari e drejtuar nga rregulla që gjenerohen nga kompetenca gjuhësore ose struktura e brendshme gramatikore e folësit.

Idetë çomskiane u përqaftuan nga Stephen Krashen dhe u përshtatën prej tij për të shpjeguar procesin e të nxënës të gjuhës së huaj në formën e një modeli të ri të njohur si Modeli Natyror i të Nxënës . Ky model, i mbështetur në disa hipoteza, hedh dritë mbi rolin e input-it të kuptueshëm si kusht i domosdoshëm për të nxënës të gjuhës. Sipas tij, input-i duhet të jetë sfidues për nxënësin (pra, më i ndërlikuar sesa përfaqësimi mendor aktual i tij për gjuhën objekt), por të mos i tejkalojë mundësitë njohëse të tij.

Mbështetur tek koncepti i Chomsky-t mbi kompetencën e performancën, Krashen-i dallon qartë dy procese të ndryshme, atë të përvetësimit i cilësuar si proces i pandërgjegjshëm dhe të nxënës, proces që aktualizohet në përpjekjet e ndërgjegjshme e të qëllimshme për të nxënës format gjuhësore, duke vënë theksin mbi pamundësinë e kalimit nga të nxënës tek përvetësimi. Më tej modeli plotësohet me arsyetimin se ankthet e të nxënës mund të çojnë në bllokimin e përvetësimit të gjuhës në çfarëdo rrethane, duke ngritur një filtër afektiv që pamundëson përdorimin e input-it të kuptueshëm.

Çfarë sjell zbatimi praktik i kësaj teorie në mjedisin e gjuhës së huaj? Sipas modelit psikolinguistik qëllimi i vërtetë i përvetësimit promovohet më së miri nga një mjedis komunikativ i pasur në input të kuptueshëm. Prania e këtij input-i, vënia e theksit tek komunikimi dhe atmosfera e ngrohtë në klasë ulin filtrin afektiv dhe nxitin nxënien e gjuhës së huaj. Megjithatë, edhe pse një qasje komunikative ndaj të nxënës të gjuhës dhe me një ndikim të gjerë në fushën e mësimdhënies, studiuesit mendojnë se kjo teori vendos një ngarkesë të madhe mbi mësuesin, pra, mbetemi në kushtet e një mësimdhënieje me në qendër mësuesin. Për më tepër, prania e input-it të kuptueshëm në vetvete nuk e garanton dobënë e tij në nxënien e gjuhës së huaj. Vetëm kur nxënësi arrin ta dallojë njësinë e input-it e ta ruajë atë në kujtesën afatshkurtër, ai brendësohet e kështu mund të shfrytëzohet për të ristrukturuar ndërgjuhën. Kjo do të thotë që nxënësi duhet të zhvillojë ndërgjegjësimin metagjuhësor për të mundësuar ndryshimin.

Kërkimet dhe zbatimet e sotme e kanë zhvendosur fokusin teorik duke sfiduar modelin natyror të Krashen-it në mbështetje të modelit sociolinguistik ndërveprues, i cili thekson, në radhë të parë, aspektin shoqëror të gjuhës dhe zbulimin e pengesave gjuhësore në procesin e komunikimit, duke e orientuar mësimdhënien e gjuhëve të huaja drejt një mësimdhënie kompetencash. Siç kuptohet edhe prej vetë termit emërtues, parimi themelor i qasjes interaksioniste është se gjuha e huaj mësohet më mirë përmes ndërveprimit shoqëror. Duhet vënë në dukje, megjithatë, se ndërveprimi për nxjerrjen e kuptimit, i cili luan rol të madh në përqëndrimin e vëmendjes së nxënësve në veprimtari, nuk “shkakton” menjëherë të nxënës të

gjuhës - kjo vjen gradualisht, me kohë dhe si rezultat i një numri të madh ndërveprimesh.

Ndryshe nga Modeli Natyror i Krashen-it, këndvështrimi interaksionist mbështetet në mësimdhënien me karakter eksplisit, pra, jo të izoluar brenda veprimtarisë njohëse të individit. Kjo risi shënon një ndryshim të dukshëm në qëndrimin ndaj TIK-ut në përgjithësi e internetit në veçanti, si një mjet i pazëvendësueshëm për të nxitur e zhvilluar mësimdhënien e kësaj forme. Studimet tregojnë se individët kanë prirje të ndërveprojnë me kompjuterin në një mënyrë thelbësisht shoqërore, njëlloj si me ndërveprimet e tyre në jetën reale. Prirja njerëzore për ta parë teknologjinë në mënyrë antropomorlike si një lloj ndihmuesi personal me të cilin bashkëpunohet për arritjen e një qëllimi, e rrit potencialin e internetit për të mbështetur procesin e të nxënimit të gjuhës së huaj.

Pikëpamja interaksioniste gjen shprehje në një sërë modelesh të ndryshme bazë për shtjellimin e të cilave ka shërbyer teoria sociokulturore e Lev Vygotsky-t. Sipas modelit të Vygotsky-t zhvillimi njohës, pra, edhe të nxënimit e gjuhës së huaj, e kanë zanafillën në ndërveprimin shoqëror. Tri postulatet bazë të kësaj teorie – (1) veprimtaria shoqërore si burim i zhvillimit e mendimit njerëzor; (2) veprimtaria e ndërmjetësuar nga shenjat; (3) Zona e Zhvillimit të Afërt, përmes kontekstualizimit të tyre në MNGJH - hedhin bazat për të thelluar perceptimin tonë rreth përfshirjes së teknologjive të internetit në mësimdhënien e gjuhëve të huaja.

Për Vygotsky-n veprimtaria njohëse ka karakter unikal njerëzor, pohim ky që mbështetet në faktin se ajo vjen si rrjedhojë e të nxënimit shoqëror, e brendësimit të shenjave shoqërore, të kulturës dhe lidhjeve po shoqërore. Në thelb, pra, njohja duhet parë si produkt shoqëror realizuar përmes ndërveprimit.

Për mësuesit e gjuhës së huaj kjo do të thotë se krijimi i mundësive për ndërveprim mes nxënësve është faktori më i rëndësishëm në nxitjen e zhvillimit të të menduarit të një rendi më të lartë. Ky këndvështrim teorik mund të konkretizohet në programin mësimor të gjuhës së huaj përmes zbatimit të formave të mësimdhënies së diferencuar, punës me projekte, të nxënimit në bashkëveprim, etj., ku TIK-u luan një rol jo të vogël.

Në analizën tonë vlen të ndalemi tek një pikë e fortë me ndikim përcaktues mbi procesin e të nxënimit të gjuhëve, siç është postulati i Zonës së Zhvillimit të Afërt. Kjo përkufizohet si distanca midis nivelit të zhvillimit aktual përshkruar nga pavarësia në zgjidhjen e detyrës dhe nivelit të zhvillimit potencial përshkruar nga zgjidhja e detyrës me ndihmën e më të rriturve apo moshatarëve më të zotë. Me këtë kuptojmë që fëmija ka aftësi të kopjojë një sërë veprimesh që i tejkalojnë kapacitetet e tij, por vetëm brenda disa kufijve. Duke kopjuar, nxënësi aftësohet të nxërë më mirë kur drejtohet nga të rriturit sesa kur lihet vetë. Në kontekstin e mësimdhënies kjo lidhet me Zonën e të Nxënimit të Afërt (ZNA), e cila përshkruhet si niveli i performancës për të cilën një nxënës është i aftë kur ka mbështetje nga ndërveprimi me një folës më të përparuar në gjuhë. Ky koncept lidhet ngushtë me

të ashtuquajturën skelë të Bruner-it, pasi ZNA-ja është praktikisht koha kur mësuesi duhet të veprojë si drejtues për të mbështetur e inkurajuar nxënësin. ZNA-ja, pra, përqëndrohet në përdorimin aktiv nga nxënësi të mjeteve të reja për të kuptuar e kryer veprimtarinë. Nxënësi, si i tillë, nuk shihet thjesht si marrës pasiv i udhëzimeve të mësuesit, përkundrazi, të dy palët ndërveprojnë ndërsjelltazi duke ndarë njohuri e përgjegjësi për detyrat. ZNA-ja, pra, përfaqëson një ndryshim fokusi nga mësimdhënia me qendër mësuesin drejt asaj me në qendër nxënësin. Mendojmë se bashkëpunimi mes nxënësve në të mësuarit e gjuhës shërben si një mekanizëm i fuqishëm për zhvendosjen përpara të ZNA-së, pasi mundëson shkëmbyeshmërinë e roleve dhe akses të vazhdueshëm drejt formave strategjike të kontrollit në përputhje me kërkesat e detyrës. Këtu shihen të mundshme të krijohen hapësira për përfshirjen e teknologjive të internetit.

Teoria e Vygotsky-t është përfaquar nga mbështetës të shumtë të qasjes sociolinguistike, siç njihet James Lantolf , i cili, duke e zgjeruar këtë teori në nxënien e gjuhës së huaj, pohon se nxënësit e gjuhës së huaj përparojnë drejt niveleve më të larta të njohurisë gjuhësore kur bashkëpunojnë dhe ndërveprojnë me folës të gjuhës së huaj që e zotërojnë atë në një shkallë më të lartë.

Teoria sociokulturore e të nxënës të gjuhës së huaj ka shërbyer si bazë për zhvillimin e mjaft modeleve pedagogjike, ndër të cilat, rëndësi për argumentin tonë paraqet teoria e konstruktivizmit shoqëror (gjerësisht e mbështetur nga studiuesit). Konstruktivizmi shoqëror në literaturën shkencore pedagogjike përkufizohet si një qasje bashkëkohore, një nga kahet më të komentuar e të gjithëpranuara të teorisë konstruktiviste që e sheh nxënësin si subjekt të të nxënës. Sipas këtij modeli të nxënës rrjedh nga një aspekt shoqëror, ku nxënësi ndërvepron e dialogon me problemin, kontekstin dhe pjesëmarrësit për të zbuluar kuptimin dhe vlerat. Procesi dhe dijet në përdorim kanë më shumë rëndësi për mbështetësit e kësaj qasjeje sesa produkti apo grumbullimi i koncepteve e fakteve të ngurta. Shoqërorja shërben si bazë për përpunimin dhe organizimin e mëtejshëm njohës të informacionit brenda individit.

Sipas këtij këndvështrimi informacioni fillimisht ndërtohet gjatë ndërveprimit shoqëror e më pas vjen e përpunohet së brendshmi nga individi (domethënë, shoqërorja na kushtëzon për mënyrën si do ta përpunojmë informacionin së brendshmi). Këtu ka vend për të bërë një paralelizëm me klasën si mjedis i të nxënës të gjuhës, pasi gjuha e re sjell me vete fragmente të kulturës që nuk mund të ndahen nga informacioni. Mësuesi, si drejtues e lehtësues i procesit, vendos me nxënësit një lidhje reciproke të pandërprerë, ku gjithsecili merr pjesë duke i shtuar komunikimit vlera dhe kuptime, vlerëson informacionin dhe e organizon atë mendërisht. Qartazi, kemi të bëjmë me një kontekst tipik të mësimdhënies me në qendër nxënësin, ku fokusi bie mbi natyrën komunikative dhe dialogun shoqëror për ndërtimin e njohurive.



Për një zbatim praktik sa më të kuptimshëm e frytdhënës të teorisë së konstruktivizmit shoqëror në klasë, nevojiten disa elementë kyç që mund të orientonin më së miri hartimin e planeve mësimore:

- Krijimi i një mjedisi mësimdhënës me në qendër nxënësin (MQN) përbën edhe parimin bazë të qasjes konstruktiviste. Nxënësi duhet të zbulojë e të krijojë kuptimin nga informacioni. Për këtë mësuesi duhet të ketë parasysh kuadrin shoqëror ku ndërvepron problemi, paraqitjen e problemit, i cili duhet t'i përfshijë nxënësit, hapësirën për të kuptuarit dhe zgjidhjen e problemit (nxënësi të aftësohet të ndërveprojë në mënyrë kritike e të ndikojë mbi problemin). Duke synuar, kështu, të kthejmë klasën në një bashkësi ndërveprimi dhe të nxëni me karakter shoqëror, ne, në të vërtetë, përmes këtij argumenti kemi arritur të perceptojmë një realitet kyç e të domosdoshëm për mjedisin e të nxënit, i cili u adresohet roleve të reja të nxënësve si njohës autonomë dhe të mësuesve si drejtues e lehtësues.

- Të nxënëtit autentik lidhet me faktin se problemi e situata nuk duhen parë jashtë kontekstit, pasi ky siguron të dhëna të domosdoshme që nxënësi duhet t'i vlerësojë gjatë analizës së tij. Nxënësit gjatë të nxënit nuk po mësojnë thjesht gjuhën, ata po përvetësojnë një sistem të ri të menduari - nuk nxënë thjesht modele leksiko-gramatikore, por, para së gjithash, njohuri mbi kulturën. Për këtë nevojitet një ekspozim sa më i madh ndaj konteksteve autentike komunikative që materialet me natyrë thjesht didaktike nuk mund ta ofrojnë. Mësimdhënia autentike nuk mund të jetë e suksesshme pa u kushtur rëndësinë e duhur bashkëbisedimit, të menduarit të një rendi më të lartë, lidhjeve me problemet e jetës reale dhe thellësisë së të kuptuarit. Të gjitha këto mbështetin fuqimisht ndërtimin e njohurive të nxënësve. Për fat, mjetet e internetit e kanë shumëfishuar në mënyrë të paimagjinueshme shkallën dhe cilësinë e ekspozimit ndaj konteksteve autentike të gjuhës, ndaj, pse të mos i konsiderojmë ato si zgjidhje për konkretizimin e parimit në fjalë?

- Të nxënëtit në bashkëpunim fokusohet në nxitjen e nxënësve drejt bashkësive të njohurisë për arsye se nxënësit e gjuhës së huaj kanë nevojë për ndërveprim aktiv e kuptimplotë, si në jetën e përditshme, për të mësuar më mirë gjuhën. Këtu nxënësit pjesëmarrës në ndërveprim bashkëndërtojnë kuptimin bazuar në atë që dinë paraprakisht, duke ndarë përvoja e ndihmuar njëri-tjetrin në ndërtimin e kuptimit.

- Vetëbesimi – mjedisi i “klasës” konstruktiviste shoqërore duhet të projektojë vetëbesimin tek nxënësit (elementi shoqëror rrit motivimin dhe besimin në vetvete).

Në këtë kuadër, analiza që sapo realizuam na ndihmon të ngremë një argument dhe të rivlerësojmë rolin e teknologjive të internetit në MGJH. Përdorimi i tyre mund ta bëjë lehtësisht të zbatueshëm të nxënëtit bashkëpunues në klasë e më gjerë, sidomos

për aspekte ku hyn elementi kulturor (karakteristike për mjedisin e gjuhës së huaj). Kur nxënësi arrin të lidhet shpirtërisht me informacionin, kuptimi i krijuar prej tij është më i fortë dhe lidhjet me njohuritë ekzistuese e kujtesën më të shëndosha, ashtu siç ndodh zakonisht në situata të botës reale me pjesëmarrës realë. Rrjedhimisht, prania e internetit dhe mjeteve të tjera të TIK-ut në mësimdhënien e gjuhës mund t'i kontribuojnë kapërcimit me sukses të pengesave gjatë të nxëniet.

## Drejtimi 2: Sa u përmbahet mësimdhënia virtuale përmes website-it parimeve universale për një dëgjim të suksesshëm?

Literatura pedagogjike na lejon të reflektojmë mbi një sërë parimesh që udhëheqin dëgjimin e suksesshëm në gjuhën e huaj, njohja e të cilave do të na shërbente mjaft në shmangien e pengesave gjatë fitimit të kësaj shprehje në gjuhën e huaj (Celce – Murcia, 1995:365).

Le të analizojmë më hollësisht natyrën e materialeve të krijuara e të përshtatura në website-in e klasës sonë (www.netenglisholsa.org) për të parë nëse integrimi i këtij mjeti në praktikën dëgjimore u përmbahet ose jo parimeve në fjalë.



Rubrika e dëgjimit në website vjen si një risi në programin e këtij projekti duke iu adresuar drejtpërdrejt kompetencës dëgjimore. Përmbajtja e saj është konceptuar e tillë që t'i vijë realisht në ndihmë përsheptimit të zhvillimit të shprehive të dëgjimit për studentët në nivelin e parë të përparuar (low advanced – FCE). I konceptuar në një cikël 14-orësh dëgjimi të shtrira në rreth 10 javë, programi i dëgjimit sjell një mori materialesh autentike nga website-e prestigjioze të një standardi të lartë të pranuar e njohur botërisht (faqja e BBC dhe VOA), si dhe mjaft materiale dëgjimi nga një sërë website-esh mësimore autoritare përmes teksteve të larmishme të dëgjimit në formë e përmbajtje, që nga intervistat reale me artistë filmash në BBC, analizat dhe sintezat e lajmeve më të fundit nga bota, siç ishte hyrja e Kroacisë në BE, apo protestat antiqeveritare në Turqi, miratimi i ligjit pro abortit në Irlandë në raste të kufizuara apo të pathënat e njerëzve që kanë bërë epokë në historinë e njerëzimit (Intervista e Thatcher-it në ish-BS). Materialet u

pasuruan me diskutime të gjalla dëgjimore mbi çështje shoqërore e kulturore që prekin gjithsecilin prej nesh, sic ishte lajmi mbi operacionin e Angeline Jolie si masë parandaluese kundër kancerit të gjirit nga i cili kërcënohej, dëshmia e dhimbshme e Enrique Ramirez mbi analfabetizmin e tij dhe luftën e gjatë për ta mposhtur atë, apo filmi mbi sfidën e përditshme të fëmijëve autikë, të cilët kërkojnë më shumë mbështetje dhe shanse në shoqëri. Përmes dialogjeve spontane, ngjarjeve nga përvoja e njerëzve të zakonshëm që vijnë vazhdimisht përmes ekstrakteve të shkurtra nga website-e mësimore e, madje, edhe kumtesave akademike në trajtën e leksioneve me tematika të ndryshme (leksioni 1 – Antarktida; leksioni 2 - Dimensioni i lirisë) kemi sjellë një mozaik përvojash interesante, komplekse dhe shpesh të panjohura. Tematika historike, shkencore, gjuhësore, politike, shoqërore e kulturore që ngacmojnë reagimin mbarëshoqëror bëhen të prekshme për studentët e këtij kursi, të cilët përjetojnë një realitet të gjallë e të paeksploruar më parë gjatë studimit online. Ky përshkrim i përmbajtjes së materialeve online shpreh qartë rëndësinë që u është kushtuar proceseve lart-poshtë, pra, thithjes së të dhënave të kontekstit, komponentit kulturor aq të domosdoshëm për lehtësimin e të nxëniet të gjuhës. Proceset poshtë-lart, pra, ato që lidhen me komponentin gjuhësor, kanë zënë një vend po aq parësor përmes larmisë së detyrave më karkater gjuhësor (fonologjik, gramatikor e leksikor), siç do ta përshkruajmë më poshtë.

Tipologjia e larmishme në formë e strukturë e teksteve të dëgjimit përbën një tjetër pikë të fortë të rubrikës së dëgjimit në fjalë, ku gërshetohen tekste me gjatësi të ndryshme që variojnë nga 2 minuta (dialogje spontane me tematikë të caktuar), në filma në trajtën e dokumentarit 10 – 15 minuta, në leksione e diskutime me karkater akademik rreth 45 minuta. Një tjetër element që bie në sy tek këto tekste është larmia e stileve, thekseve e regjistrave gjuhësorë, ashtu siç ndeshemi në jetën e përditshme, nga anglishtja britanike tek ajo amerikane, nga gjuha e përditshme tek ajo poetike, shkencore apo gazetareske; nga gjuha e fëmijës tek ajo e specialistit. Gama e gjerë aktualizohet edhe në llojin e materialit të ofruar për studim - audio, video, herë e shoqëruar e herë jo me transkriptim të pjesshëm, materiale dëgjimi me informacion paraprak të përmbledhur, shpesh edhe audio cilësore nga website-e mësimore me veprimtari paradëgjimore, dëgjimore e pasdëgjimore që i ofrohen të gatshme studentit, madje në përfundim të ushtrimit ata mund të vetëkorrigjohen në ballafaqim me përgjigjet e sakta, duke u hapur rrugë edhe formave të vetëvlerësimit.

Larmia e teksteve dëgjimore pasohet edhe nga një tipologji e gjerë detyrash e veprimtarish përmes të cilave synohet të zhvillohen tipat e ndryshëm të dëgjimit, si: për informacion specifik, për informacion global (idenë kryesore, tonin apo fokusin e përgjithshëm të një teksti) si dhe dëgjimi midis rreshtave (inferenca). Për konkretizim, disa nga llojet e veprimtarive të kryera më shpesh janë ato të tipit zgjedhje me alternativa, plotësim fjalish mungesore përmes përshkrimit,

përkufizim termash në varësi të të dhënave në tekst, dhënie përgjigjesh të argumentuara ndaj pyetjeve të ngritura, e vërtetë/e gabuar, ushtrime fjalori, mbajtje shënimesh, detyra me karakter krijues (intervista), riprodhim fjalë për fjalë i një segmenti të caktuar të tekstit, realizim i përmbledhjes së një materiali, krahasim i perspektivave mes dy materialeve të ngjashme. Përmbushja e këtyre detyrave në fletë pune pasohet me veprimtaritë reflektuese – komente në faqe ose në forum (sipas kërkesës).

Nisma e ndërmarrë bëhet sfiduese edhe për arsye se krijimi i materialeve ka kërkuar një periudhë e gjatë hulumtimi në website-e autoritare që siguronin video dhe audio në përputhje me pritshmëritë e programit për këtë nivel formimi. Çdo material i zgjedhur është përpunuar e analizuar më tej duke pasur për udhërrëfyes metodik strategjitë e dëgjimit të konceptuara në disa hallka: veprimtari paradëgjimore, dëgjimore dhe pasdëgjimore, duke u kërkuar studentëve të marrin informacion paraprak të nevojshëm për të parashikuar atë që duhet të dëgjojnë (psh., të dhëna mbi jetën dhe veprimtarinë e Aung San Suu Kyi – lidere e opozitës në Birmani, e cila mban një leksion mbi lirinë, etj). Gjatë dëgjimit të materialit studentëve u kërkohet të mbajnë shënime dhe t'u përgjigjen kërkesave të tipeve të ndryshme. Ndërkaq, studentët monitorojnë në vazhdimësi punën e tyre duke ngritur pyetje e duke marrë sqarime përmes email-it. Për fazën pasdëgjimore nxënësve përgjithësisht u kërkohet të shprehen në forumin e grupit për të dhënë reflektimin e tyre lidhur me temën e porsadëgjuar.

Ky përshkrim i hollësishëm i natyrës së materialeve të krijuara në website dëshmon se konceptimi i tyre dhe realizimi i punës me to u përgjigjet parimeve për një dëgjim të suksesshëm. Sigurisht, në sajë të bashkëpunimit të vazhdueshëm ndërstudentor e pedagog-student duket se gjithçka ka funksionuar në dobi të një pune efektive akademike – mësimore në një mjedis nxitës e komod.

## **PËRFUNDIME**

Në këtë punim ndërmorë një shqyrtim kërkimor - analitik të lidhjes mes përdorimit të website-it si mjedis e mjet për mësimdhënien e dëgjimit dhe zhvillimin e kesaj kompetencës në nivel të përparuar studentor. Metodologjikisht çështja në fjalë u trajtua në punimin tonë si një çështje e hapur. Realizimi i një eksperimenti që na siguroi me të dhënat e nevojshme empirike për të faktuar çdo argument e interpretim nxori në pah se, së pari, mësimdhënia virtuale përmes website-it u përmbahet rreptësisht standardeve pedagogjike për një dëgjim të suksesshëm si në drejtim të autenticitetit të materialeve, domosdoshmërisë për t'u mëshuar proceseve të ashtuquajtura nga lart-poshtë (up-down), ashtu edhe atyre nga poshtë-lart (bottom-up); ekspozimit të studentëve ndaj tipave të ndryshëm të dëgjimit dhe detyrave të shumëllojshme; marrjes në konsideratë e shkallës së vështirësisë së tekstit e deri tek njohja dhe përdorimi sistematik i strategjive të

dëgjimit, duke i atribuar website-it tiparet unike të një katalizatori në zhvillimin e shprehive dëgjimore në gjuhën angleze.

Kontekstualizimi i materialeve dëgjimore online brenda një kuadri shumë më të gjerë e domethënës se ai që ofron klasa tradicionale i nxit dhe u krijon mundësinë studentëve të shohin horizontin e gjerë kulturor përtej elementit gjuhësor të teksteve, pra, përbën edhe avantazhin e madh të mësimdhënies online në lidhje me promovimin edhe të kompetencës ndërkulturore.

## **BIBLIOGRAFIA**

Atay, D., Kurt G., Çamlıbel, Z., Ersin, P., & Kaslioglu, Ö.(2009), The Role of Intercultural Competence in Foreign Language Teaching. *Inonu University Journal of the Faculty of Education*, 10/3, 123-135.

Blake, R. J. (2008), *Brave New Digital Classroom – Technology and Foreign Language Learning*, Washington D.C., George Town University Press.

Brown, H. D. (2007), *Teaching by Principles: An Interactive Approach to Language Pedagogy*, San Francisco. Pearson Education ESL.

Byram, M.(1997), *Teaching and Assessing Intercultural Communicative Competence*. Clevedon: Multilingual Matters.

Byram, M. dhe Tost Planet, M.(2001),*Social identity and European dimension. Intercultural Competence through Foreign Language Learning*. Graz: Council of Europe.

Celce-Murcia, M. (1995), *Discourse Analysis and the Teaching of Listening*,përg. G. Cook dhe B. Seidlhofer, *Principle and Practice in AppliedLinguistics*, 363-378. Oxford: Oxford University Press.

Corbett, J. (2003), *An Intercultural Approach to English Language Teaching*. Clevedon: Multilingual Matters.

Council of Europe (2001),*Common European Framework of Reference for Language Learning, Teaching, Assessment*. Cambridge: Cambridge University Press.

Gilman, R. A. dhe Moody, L. M. (1984), *What Practitioners Say about Listening: Research Implications for the Classroom*. *Foreign Language Annals*, 17, 331-334.

Larzén, E. (2005), *In Pursuit of an Intercultural Dimension in EFL-Teaching*. Finland: ABO Akademi University Press.

Pennington, M. (1995), *The Teacher Change Cycle*.*TESOL Quarterly*, vëll. 29/4, 705-731.

Schulz, R. A. (2007), *The Challenge of Assessing Cultural Understanding in the Context of Foreign Language Instruction*. *Foreign Language Annals*, 40(1), 9-26.

Straffon, D. A. (2003). *Assessing the Intercultural Sensitivity of High School Students Attending an International School*. *International Journal of Intercultural Relations*, 27, 487–501.

Teeler D., Gray P. (2001),*How to Use the Internet in ELT*, Pearson Education Limited.

Turkle, Sh. (1996). *Life on the Screen. Identity in the Age of the Internet*. New York: Touchstone.

Van Dijk, T., A. (1993). Principles of Critical Discourse Analysis. *Discourse & Society*, 4/2, 249-283.

Warschauer, M. (1996), *Virtual Connections: Online Activities and Projects for Networking Language Learners*, Honolulu, HI: University of Hawaii Second Language Teaching and Curriculum Center.

## ***SECTION II***

### ***PRACTICAL CONCERNS ON HOW TO FACE THE CHALLENGES OF INCORPORATING DIGITAL TOOLS TO ESL TEACHING***

## CHALLENGES OF INCORPORATING DIGITAL TOOLS TO ESL TEACHING

**Dr. Erinda Papa**

[epapa@unkorce.edu.al](mailto:epapa@unkorce.edu.al)

**Dr. Eriola Qafzezi**

[eqafzezi@unkorce.edu.al](mailto:eqafzezi@unkorce.edu.al)

**Daniela Carmen Stoica, PhD**

[dstoica@unkorce.edu.al](mailto:dstoica@unkorce.edu.al)

THE EDUCATIONAL WORLD IS CHANGING. FOR YEARS, WE HAVE SEEN AN INCREASE IN THE NUMBER OF ONLINE LEARNING OPPORTUNITIES.

The landscape of education is undergoing a profound transformation with the burgeoning prevalence of digital English language learning opportunities. Over the years, there has been a noticeable surge in the adoption of online platforms and tools designed to facilitate language acquisition. This shift is driven by a confluence of factors, including advancements in technology, globalization, and the increasing recognition of the importance of English proficiency in the interconnected world. The traditional model of language education, confined to physical classrooms and textbooks, is giving way to dynamic and interactive digital platforms that offer learners flexibility and accessibility. As a result, individuals across the globe now have the chance to engage with English language learning resources at their own pace, breaking down geographical barriers and democratizing access to quality education.

